

NJOFTIM MBI ANULIMIN E PJESEVE/LOT TË PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Në përputhje me nenin 47 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024)

Data: 03.06.2025

I. “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës”
Adresa: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë

II. Lënda e procedurës së prokurimit:

II.1 Titulli i kontratës: “Furnizim me pajisje harduerike të IT-së” (8 pjesë/lot)

II.2 Numërtimi i prokurimit: “BQK 25 011 111”

II.3 Lloji i procedurës: *Procedurë e hapur (neni 10 i Rregullës për Prokurimin në BQK)*

II.4 Lloji i prokurimit: “Furnizim”

II.5 Numri i tenderëve të pranuar në këtë procedurë për 8 pjesë/lot: 7 (shtatë)

III. Anulimi i procedurës së prokurimit:

III.1 Data e anulimit të pjesëve/lot të procedurës: 03.06.2025

III.2 Pjesët/lotet e anuluar:

- Pjesa/lot 2 “Laptop per stafin e TI-se” dhe
- Pjesa/lot 5 “Firewall per lidhje me VPN”

III.3 Arsyet e anulimit: Anulimi i këtyre dy pjesëve/lotëve të kësaj procedure të prokurimit bëhen në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në BQK”, konkretisht sipas nenit 47, paragrafët 2 dhe 3. Vendimi i Bankës Qendrore për anulim sipas nenit në fjalë vjen si rezultat e mos përmbushjes nga ana e tenderuesve të kushteve si vijon:

- Pjesa/lot 2 “Laptop per stafin e TI-se” asnjëri nga katër tenderuesit nuk arriti t’i plotësoj kushtet administrative dhe teknike të tenderit:

Tenderuesi	“Cactus” Sh.a.	“Source” Sh.p.k.	“Aritech” Sh.p.k.	“Storm” ICT
	Oferta e “Cactus” Sh.a u refuzua nga procedura për arsye se nuk i përmbushi kërkesat	Oferta e “Source” Sh.p.k. nuk i plotësoi kërkesat për specifikat	Oferta e “Aritech” Sh.p.k. nuk i plotësoi kërkesat për specifikat teknike të tenderit	Oferta e “Storm” ITC u nuk i plotësoi kërkesat për specifikat

	formale të tenderit	teknike të tenderit		teknike të tenderit
--	---------------------	---------------------	--	---------------------

- b) Pjesa/lot 5 “Firewall per lidhje me VPN” tenderuesi i vetëm konzorciumi “Advanced Business Solutions – ABS Sh.p.k. dhe ABS Kosova Sh.p.k.” nuk arriti t’i plotësoj specifikat teknike të tenderit:

Tenderuesi	“Advanced Business Solutions – ABS Sh.p.k. dhe ABS Kosova Sh.p.k.”
	Oferta e konzorciumit ABS nuk i plotësoi kërkesat për specifikat teknike të tenderit

IV. Ankesat

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024), respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar¹ mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.

¹ “Palë e interesuar”, sipas pikës 1.26 të nenit 2 të “Rregullës për Prokurimin në BQK” cilësohet operatori ekonomik që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i një aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga Banka Qendrore në raport me një kontratë të prokurimit.